



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 24.27.1--2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË INSTITUCIONIT TË
AVOKATIT TË POPULLIT PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31
DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Institucionit të Avokatit të Popullit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Liridona Berisha Kelmendi (udhëheqëse ekipi), Mjellma Dibra Morina dhe Mimoza Morina Kelani (anëtarë të ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Ramadan Gashi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	14
5 Qeverisja e mirë.....	15
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	17
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme	20
Shtojca III: Komentet e OB-së në gjetjet e raportit të auditimit.....	22
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	24

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 26/04/2018.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Institucionit të Avokatit të Popullit.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Institucionit të Avokatit të Popullit për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.


Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit-2017**

Menaxhmentit ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me pjesën më të madhe të gjeturave të detajuara dhe konkluzionet e auditimit. Komentet për të cilat janë pajtuar pjesërisht apo nuk janë pajtuar mund t'i gjeni në shtojcën III.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Institucionit të Avokatit të Popullit. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Zyrtari kryesor financiar është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Avokati i Popullit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

IAP-së i kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 02/2013 ;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK) ;
- Pasqyrat Nëntëmujore me kohë; dhe
- PVF janë përgatitur me kohë dhe nënshkruar nga ZKA dhe ZKF.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

Në PFV kemi identifikuar dobësitë, si në vijim:

- Neni 14 - Te raporti i ekzekutimit të buxhetit kolona e realizimit - tek grantet e përcaktuara të donatorëve është prezantuar donacioni i shpenzuar në vlerë 35,523€, ndërsa do të duhet të prezantohet vlera 50,356€ të cilat janë pranuar gjatë vitit 2017; dhe
- Neni 24 - Te raporti për fondet e donatorëve të pashpenzuara për bartje - nuk ishte shpalosur vlera e pashpenzuar e donacioneve prej 14,832€.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I IAP-së

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në MF është e saktë dhe e drejtë, për shkak se gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime materiale.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi 1 Avokati i Popullit duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet lidhur me prezantimin jo të duhur tek realizimi i buxhetit dhe donacioneve të pashpenzuar në PFV. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet në Ministri të Financave, përveç nëse ndaj PFV janë aplikuar të gjitha kontrollet dhe rishikimet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

IAP në përgjithësi ka kontrolle të duhura në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera megjithatë, nevojiten përmirësime në menaxhimin e pasurive.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	1,336,219	1,201,074	963,723	1,013,390	882,383
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,336,219	1,150,719	928,199	991,662	882,383
Donacionet e jashtme	-	50,357	35,525	21,728	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 135,145€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i rishikimit të ligjit të buxhetit.²

Në vitin 2017, IAP ka shpenzuar 963,723€ apo 80% të buxhetit final, me një zvogëlim prej 18% krahasuar me vitin 2016.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

² Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 05L-125 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,336,219	1,201,074	963,723	1,013,390	882,383
Pagat dhe Mëditjet	920,366	857,147	689,331	618,206	601,535
Mallrat dhe Shërbimet	324,353	303,427	235,219	324,720	268,897
Shërbimet komunale	25,500	25,500	24,524	20,264	11,951
Investimet Kapitale	66,000	15,000	14,647	50,200	-

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 63,219€. Ky zvogëlim ishte rezultat i mos plotësimit të 15 pozitave me staf të rregulltë gjatë viti 2017. Përkundër këtij zvogëlimi realizimi i buxhetit final për këtë kategori ishte në nivel jo të kënaqshëm (80%);
- Me rishikim të buxhetit, kategoria e mallrave dhe shërbimeve ishte zvogëluar për 20,926€. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte vetëm 78%, kjo pasiqë nuk janë zhvilluar aktivitetet të promovimeve për IAP;
- Në kategorinë e shërbimeve komunale buxheti final në raport me buxhetin fillestar nuk kishte ndryshime, dhe se realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 96%; dhe
- Buxheti final për e investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 51,000€. Në këtë zvogëlim ka ndikuar mos realizimi i projektit 'Blerja e tri automjeteve' pas njoftimit të AQP për prokurim të centralizuar. Realizimi për këtë kategori ishte 14,647€ apo 98% të cilat kanë të bëjnë për projektin 'Furnizimi me paisje përkthimi'.

Çështja 2- Ekzekutimi i buxhetit

- E gjetura** Shpenzimi i buxhetit sipas kategorive ekonomike, nxjerr në pah një nivel relativisht të ultë të ekzekutimit të buxhetit për paga dhe mëditje prej 80% (mjete të pashpenzuara 167,816€) dhe mallra dhe shërbime prej 78% (mjete të pashpenzuara 68,208€) gjatë vitit 2017. Kjo ka ndodhur pasi që ishte planifikuar buxheti për 15 pozita me staf të rregulltë gjatë vitit, mirëpo këto pozita nuk ishin rekrutuar, si dhe nga anulimi i shpeshtë i procedurave të prokurimit.
- Rreziku** Planifikimi jo i duhur ka ndikuar në mos arritjen e objektivave të organizatës me ecuritë e shpenzimeve për paga dhe mëditje dhe mallra dhe shërbime.
- Rekomandimi 2** Avokati i Popullit duhet të sigurojë që me rastin e planifikimeve buxhetore të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i burimeve potenciale (mjeteve financiare) dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të buxhetit në paga dhe mëditje dhe mallra e shërbime.

3.2 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave (payrollit) që menaxhohet nga MAP dhe MF. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave janë listat e pagave të nënshkruara nga udhëheqësit e njësive organizative.

Ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e pagave dhe pagesat sipas kontratës (punëtorët aktual, rekrutimet, largimet, pushimet e lehonave). Në mostrat e testuara nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.3 Menaxhimi i personelit

Numri i aprovuar i të punësuarave në IAP ishte 78, ndërsa numri aktual i të punësuarve në fund të vitit ishte 63³ punonjës. Ne kemi testuar një numër mostrash për të siguruar se veprimet e ndërmarrura në këtë fushë janë në harmoni me rregulloret e zbatueshme. Nga testimet tona nuk kemi identifikuar ndonjë çështje për t'u raportuar.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për kategoritë mallra e shërbime dhe shërbime komunale në vitin 2017 ishte 328,927€. Prej tyre ishin shpenzuar 259,744€. Pjesa më e madhe e shpenzimeve në këto kategori përfshijnë, shpenzimet për furnizim për zyrë, shpenzimet tjera kontraktore dhe shpenzimet të telefonisë mobile. Në mostrat e testuar nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 15,000€, ndërsa ishte shpenzuar 14,647€. Shpenzimet kishin të bëjnë me blerjen e pajisjeve për përkthim. Nga mostra e testuar nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

³ Për shkak se 15 pozita ende nuk ishin të plotësuara.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.6 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuria kapitale e IAP mbi 1,000€ e shpalosur në PVF ishte në vlerë 68,564€, pasuria jo-kapitale nën 1,000€ ishte në vlerën 66,480€, si dhe stoqet 24,009€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit, mbajtja e evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullores MF nr.02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore. Auditimi ynë mbi menaxhimin e pasurisë identifikoi dobësitë e paraqitura më poshtë.

Çështja 3 – Menaxhimi i pasurisë

E gjetura IAP kishte formuar komisionet për inventarizim⁴ dhe vlerësim⁵ të pasurive, të cilat kishin evidentuar pasuri prej 43⁶ sosh (pasije/inventar) që ishin jashtë përdorimit dhe figurojnë në regjistër të pasurive duke i rekomanduar menaxhmentit që të largohen nga regjistri i e-pasurisë. Kemi vërejtur se përkundër rekomandimit të komisioni të vlerësimit këto pasuri nuk ishin larguar nga regjistri i pasurive, siç kërkohet me nenin 9 të rregullës 02/2013.

Rreziku Mbajtja në regjistrin e pasurive, pasurit të cilat janë jashtë përdorimit, rezulton që sistemi i e-pasurisë mund të nxjerr informata jo të sakta dhe të rrit rrezikun që pasuritë të mbivlerësohen dhe prezantimi i tyre në PFV të mos jetë i saktë.

Rekomandimi 3 Avokati i Popullit duhet të sigurojë që menaxhimi i regjistrave bëhet në përputhje me rregulloren për menaxhimin e pasurive, përkatësisht të sigurojë largimin e pasurive jashtë përdorimit sipas vlerësimeve të komisionit përkatës.

3.7 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 1,353€. Në përgjithësi IAP ka kontrollë efektive në menaxhimin e detyrimeve. Vlera e mbetur si obligim ishte për shkak se, pjesa më e madhe e faturave të pranuar ishin pranuar në muajin dhjetor 2017. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

⁴ Vendimi i datës 22.12.2017.

⁵ Vendimi me nr. të protokollit 01/2018 i datës 11.01.2018.

⁶ (monitor, shtëpiza, Ups, telefona mobil dhe tavolina pune) .

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016, ka rezultuar me pesë rekomandime. IAP kishte përgatitur një Plan Veprimi brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit të auditimit, në të cilin kishte paraqitur mënyrën se si do të zbatohen rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, pesë rekomandimet e dhëna janë zbatuar. Për më tepër, nga viti 2015 ishin bartur katër rekomandime, ku prej tyre tre rekomandime ishin zbatuar dhe një ishte në proces të zbatimit. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë përfshinë parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisja e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit, pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzojnë në Ministrinë e Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

IAP ka përgatitur regjistrin⁷ e rreziqeve, duke identifikuar disa rreziqe që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj, mirëpo nuk ishte bërë monitorimi i tyre.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit, ku IAP kishte zbatuar pjesën më të madhe të rekomandimeve. Po ashtu, pyetësi i vetëvlerësimit ishte përfunduar me kohë si kërkesë ligjore të parapara me rregullat e MFK-së.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Auditimi i brendshëm është segment i rëndësishëm për të siguruar menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe zbatohen në mënyrën e duhur. Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) përbëhet nga një auditor (Drejtori i NJAB) i cili kishte të aprovuar planin vjetor dhe strategjik. NJAB për vitin 2017 kishte planifikuar dhe kryer pesë auditime të rregullta dhe një auditim me kërkesë të menaxhmenti.

NJAB kishte përmbushur në tërësi planin e auditimit duke dhënë 10 rekomandime për përmirësimin dhe funksionimin e kontrolleve të brendshme prej tyre pesë ishin zbatuar dhe pesë prej tyre ishin në proces të zbatimit.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

⁷ Regjistri i rreziqeve i datës 19.12.2017.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

Procesi i raportimi të brendshëm në IAP funksionon sipas zingjirit llogaridhënës dhe strukturës organizative. Lidhur me këtë, menaxhmenti mban takime të rregullta me të gjithë drejtuesit e departamenteve dhe ato shoqërohen me procesverbale dhe raportime.

Çështja 4 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

E gjetura Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar ka identifikuar kontrolle jo efektive në menaxhimin e pasurisë.

IAP ka të hartuar strategjinë dhe regjistrin e rreziqeve sipas kërkesave të MFK-së, në të cilin i ka identifikuar sfidat dhe vështirësitë që përballet gjatë aktiviteteve të përditshme, megjithatë, ne kemi vërejtur se nuk ishte bërë monitorimin i regjistrit të rreziqeve të identifikuar dhe se si janë ndërmarrë veprimet për të zbutur këto rreziqe karshi objektivave të përcaktuara në këtë dokument.

Rreziku Mungesa e menaxhimit efektiv të rreziqeve dhe të kontrolleve do të ndikojë në mos adresimin me kohë të mangësive, duke reduktuar kështu efektivitetin dhe ndikon në mos përmbushjen e objektivave dhe planeve të synuara.

Rekomandimi 4 Avokati i Popullit duhet t'i shqyrtoj shkaqet e mos aplikimit të kontrolleve në mënyrë efektive në fushat e cekura më lartë dhe të sigurojë monitorim të vazhdueshëm të listës së rreziqeve dhe raportim tremujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2.5.1 Vlerësimi I rrezikut	Avokati i Popullit duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.		IAP me 19.12.2017 kishte implementuar rekomandimin e dhënë duke hartuar regjistrin e rreziqeve karshi objektivave, mirëpo nuk kishte bërë monitorimin e atyre rreziqeve.	
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Avokati i Popullit duhet të zbatojë një proces efektiv për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm, i cili përcakton kohën e synuar dhe zyrtarët përgjegjës për këtë. Për rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.	IAP i kishte zbatuar të gjitha rekomandimet.		
2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së	Avokati i Popullit duhet të sigurojë se është rishikuar procesi i plotësimit të pyetësorit të vet-vlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësorit si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.	IAP kishte hartuar planin vjetor të punës nr. 147/2017 i datës 14.07.2017.		

2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Avokati i Popullit duhet të sigurojnë një strukturë organizative në të cilën ekziston një ndarje e duhur e detyrave dhe përgjegjësi, si dhe një linjë e qartë e raportimit dhe llogaridhënies. Në këtë aspekt në periudhën sa më të shkurtë kohore të ndërmarrë veprimet e duhura për plotësimin e pozitës së Zyrtarit Kryesor Financiar.	IAP kishte përzgjedhur udhëheqës i divizionit për buxhet dhe financa/ Zyrtar Kryesor Financiar më 02.10.2017.		
3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Avokati i Popullit duhet të forcoj kontrollet në realizimin e shpenzimeve dhe të siguroj pajtueshmëri të plotë me hapat e përcaktuara me LMFPP-në dhe me rregullat e Thesarit.	IAP e kishte implementuar rekomandimin e dhënë duke ju përmbajtur rregullës së thesarit 01/2013 shpenzimi i parasë publike.		
3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Avokati i Popullit duhet të përmirësoj nivelin e kontroleve në realizimin e shpenzimeve dhe të sigurojë se shpenzimi i parave publike bëhet në përputhje me ligjin e buxhetit dhe ligjin për menaxhimin e financave publike dhe nuk do lejohen pagesa në formë dhuratave nga kategoria mallra dhe shërbime.	Gjatë ekzekutimit të auditimit për mostrat e testuara nuk kemi vërejtur në ndonjë procedurë/pagesë që është në formë të dhuratave për të punësuarit.		

Shtojca III: Komentet e OB-së në gjetjet e raportit të auditimit

Të gjeturat/çështjet	<u>Pajtohemi</u> <u>po/jo</u>	Komentet e IAP ⁸	Pikëpamjet e ZKA
<p>Çështja nr. 3 “Menaxhimi i pasurisë”.</p> <p>E gjetura: “IAP kishte formuar komisionet për inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive, të cilat kishin evidentuar pasuri prej 43 sosh (pajisje/inventar) që ishin jashtë përdorimit dhe figurojnë në regjistër të pasurive duke i rekomanduar menaxhmentit që të lrgohen nga regjistri i pasurisë. Kemi vërejtur se përkundër rekomandimit të komisionit vlerësimit këto pasuri nuk ishin larguar nga regjistri i pasurisë, siç kërkohet me nenin 9 të rregullorës 2/2013”.</p>	JO.	<p>Me këtë gjetje nuk pajtohemi sepse:</p> <p>1.Sipas nenit 9 të Rregullorës nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në OB (organizatat buxhetore), me asnjërin paragraf nuk është e kufizuar koha/data e fundit për tjetërsimin e pasurive jo financiare, si obligim ligjor të cilin që duhet t’a zbatojnë OB për kryejën e tjetërsimit të pasurive jo financiare brenda këtij afatti, pra si në këtë rast lidhur me largimin e këtyre pasurive nga regjistri i pasurive për vitin paraprak, pas përfundimit të inventarizimi të kësaj pasurie.</p> <p>2.Prandaj, “rreziku” për mbajtjen e këtyre pasurive në regjistrin e pasurive për vitin 2018 e vlerësojmë se nuk është i drejtë për këtë çështje/gjetje. Ky “rrezik” dhe kjo “çështje/gjetje” mund të jetë e vlefshëm dhe i pranuaeshëm vetëm nëse IAP gjatë vitit kalendarik 2018 nuk merr veprimet për tjetërsimin e kësaj pasurie jo financiare, respektivisht nëse kjo pasuri e evidentuar si jashta përdorimit do të bartet në regjistrin e pasurive të IAP edhe në/për vitin 2019;</p>	<p>Sipas të dhënave nga komisioni i vlerësimit është evidentuar se IAP në regjistrat e pasurisë posedon pasuri jashtë përdorimit (dëmtuara/prishura). Sipas rregullës financiare 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare⁹ -Pasuria jo financiare jashtë përdorimit nuk do të prezantohet në pasqyrat financiare por duhet të shpaloset.</p> <p>IAP nuk kishte ofruar dëshmi për këtë proces, prandaj e gjetura nuk ndryshohet.</p>

⁸ Për korrektësi nuk kemi ndërhyrë në aspekt gjuhësor në komentet e IAP.

⁹ Rregullës financiare 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë, neni 24 pika 4.

		<p>3. Bazuar në nenin 9 të Rregullorës nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në OB, respektivisht pika 5, pasuar nga pikat 6,7,8, 9 dhe 10 të po këtij neni, konsiderojmë se është e pamundur që ligjërisht të kryhet tjetërsimi i kësaj pasurie jo financiare brenda afatit ligjor për nevojat e korigjimit të PVF deri më datën 31 mars. Kurse, përderisa procedurat e tjetërsimit të pasurisë jo financiare nuk janë të kufizuara sipas kësaj rregullore, dhe në anën procedurë e tjetërsimit me kohë për kryerjen e plotë dhe të drejtë të tjetërsimit, pa marr se cila procedurë e tjetërsimit mund të aplikohet nga OB, pra cilado qoftë ajo procedurë: shitja (ankandi publik), transferi, dhënia (donacioni) apo asgjësimi sipas nenit 9 të rregullores 02/2013, në mënyrë që edhe zyrtari i pasurisë të arrijë të bëjë shlyerjen e tyre në MF në sistemin e Free Balanc-it.</p> <p>4. PVF-të e IAP për vitin 2017, lidhur me këtë rast konsiderojmë se prezantojnë informata të sakta për të pasuritë jo financiare, ngase janë të bazuara dhe të prezentuara në bazë të Raportit të Komisionit për Vlerësimin e pasurive jo financiare të datës 31.01.2018. Kurse, rekomandimin e këtij komisioni për vlerësim të pasurive jo financiare lidhur me tjetërsimin e këtyre pasurive e kemi në procedur dhe do ta realizojmë sipas ligjeve dhe gjatë vitit kalendarik 2018. IAP në vazhdimësi (edhe viteve paraprake) e ka kryer tjetërsimin e pasurive me procedurat dhe kriteret për tjetërsimin e pasurisë jo financiare sipas nenit 9 të Rregullorës nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në OB.</p>	
--	--	--	--

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë,
11 qershor 2018

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, ju njoftoj dhe konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2017, (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- Pajtohem pjesërisht (nuk pajtohem me Çështjen/Gjeturen e Rekomandimin nr. 3) me të gjeturat dhe rekomandimet, me që rast komentim për këtë çështje/gjeture e rekomandim ia bashkëngjitem kësaj leter konfirmimi; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Paraprkishtë, ju faleminderit për mirëkuptim dhe bashkëpunimin tuaj.

Me nderime,

Jashar Kastrati,
Sekretar i Përgjithshëm,
Institucioni i Avokatit të Popullit.

